



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE DHE
ÇËSHTJEVE FISKALE
DREJTORIA E AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 31.1.2023

RAPORT

MBI

**VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT
PËR VITIN 2022**

Në zbatim të nenit 105/2, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 28.7.2010, “*Për Avokatin e Tatimpaguesit*”, të ndryshuar, si dhe pikës 5 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 25.2.2019, “*Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga avokati i tatimpaguesve*”, të ndryshuar, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, në ushtrim të funksionit dhe në fushën e vetë të përgjegjësisë, paraqet këtë raport mbi veprimtarinë e saj për vitin 2022.

I. Misioni i Avokatit të Tatimpaguesit

Avokati i Tatimpaguesit mbron interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore.

Ai autorizohet të investigojë të gjitha kërkesat apo ankesat e tatimpaguesve që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektim të procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë.

Në përmbushjen e misionit të tij ligjor, Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin që:

- të kërkojë informacion dhe sqarime nga të gjithë punonjësit e administratës tatimore;

- të urdhërojnë Drejtoritë Rajonale Tatimore (DRT) për evidentimin e informacioneve dhe për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve të veçantë apo grupeve të tatimpaguesve;
- të urdhërojnë Drejtoritë Funkzionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të shqyrtuar procedura të caktuara të administrimit tatimor;
- të rekomandojnë përmirësimin e procedurave tatimore, dhe po të jetë rasti edhe ndryshime në legjislacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore;
- të referojnë raste të veçanta në DPT, përkatësisht në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor ose Drejtorinë e Hetimit Tatimor, nëse informacioni apo dokumentacioni lidhur me një ankesë konkrete nga tatimpaguesi tregon se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo hetimit tatimor;
- të referojnë raste të veçanta tek Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ose Drejtoria e Investigimit të Brendshëm, nëse informacionet e administruara nga Avokati i Tatimpaguesit, në mënyrë të përsëritur, i referohen sjelljeve të papërshtatshme të punonjësve/inspektorëve të caktuar apo keqpërdorimit të procedurave, sistemeve dhe autoritetit zyrtar prej tyre, duke treguar se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo investigimit të brendshëm për ata punonjës të administratës tatimore apo në procedurat e sistemet përkatëse;
- të propozojnë masa disiplinore për punonjësit të cilët nga analizimi i rasteve të shqyrtuara prej tij, rezulton se nuk respektojnë procedurat apo i shkelin ato me dashje, megjithëse përgjegjësia kryesore për propozime të tilla i takon drejtorëve rajonalë ose funksionalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Avokati i Tatimpaguesit ka si funksion parësor:

- sigurimin e një informacioni eficient;
- prezantimin në hallkat administrative përkatëse të problemeve e të shqetësimeve të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe të procedurave përkatëse administrative;
- garantimin e respektimit të të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

Avokati i Tatimpaguesit ka këto funksione të tjera:

- evidentimin, klasifikimin dhe trajtimin e drejtë të çdo ankesë të marrë nga tatimpaguesit;
- bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit;

- bashkëpunimin me drejtoritë funksionale në DPT për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen në mënyrën e duhur nga punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me Kodin e Etikës;
- ndjekjen dhe trajtimin me korrektësi të çdo rasti individual dhe mbylljen e arkivimit të tyre vetëm pasi ankesat të jenë trajtuar e zgjidhur në përputhje me legjislacionin tatimor dhe dispozitat e Kodit të Etikës;
- bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, drejtorinë e burimeve njerëzore dhe sektorin e trajnimit, me qëllim që nga përfundimet e nxjerra nga rastet e veçanta në të gjitha drejtoritë rajonale tatimore, të garantohet mospërsëritja e gabimeve;
- dhënien e rekomandimeve për masa administrative ndaj punonjësve të administratës tatimore, të cilët kanë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës;
- referimin e rasteve të veçanta Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm ose Drejtorisë së Investigimit Kriminal, nëse informacioni apo dokumentacioni i nxjerrë tregon se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të investigimit administrativ ose penal;
- bërjen e propozimeve Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për përmirësime në proceset e punës dhe në procedurat tatimore, si dhe në dispozitat e Kodit të Etikës, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përmbushjen e detyrimeve tatimore.


II. Veprimtaria e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit për vitin 2022

1. Praktikat e trajtuara gjatë vitit 2022


Praktikat e trajtuara gjatë vitit 2022		Numri i praktikave të trajtuara
1.	Drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit	132
	<i>nga këto:</i>	
1.1.	Hetim administrativ lidhur me ankesat e tatimpaguesve	25
	<i>nga këto:</i>	
a)	Zgjidhur nga DRT/DPT	22
b)	Në proces	3

1.2.	Ankesa/Kërkesa të ardhura në rrugë elektronike	46
	<i>nga këto:</i>	
1.2.1.	Ankesa/Kërkesa drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit	37
a)	Trajtuar nga Avokati i Tatimpaguesit	12
	<i>nga të cilat:</i>	
	- Zgjidhur	10
	- Në proces	2
b)	Përcjellë pranë Administratës Tatimore	25
	<i>nga të cilat:</i>	
	- Zgjidhur	23
	- Në proces	2
1.2.2.	Ankesa të ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes	9
	<i>nga këto:</i>	
	-Trajtuar dhe dhënë përgjigje	9
	- Në proces	0
1.3	Kërkesa për sqarim ligjor	22
	<i>nga këto:</i>	
a)	Trajtuar nga Avokati i Tatimpaguesit	6
b)	Përcjellë për trajtim nga DPT	13
c)	Përcjellë për trajtim njësive të vetëqeverisjes vendore	3
1.4	Përcjellë për moskompetencë	21
	<i>nga këto:</i>	
a)	Përcjellë strukturave brenda MFE	6
b)	Përcjellë DPT-së	11
c)	Përcjellë institucioneve të tjera	4
1.5	Ardhur për dijeni Avokatit të Tatimpaguesit	18
2	Praktika të deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm	136
GJITHSEJ		268

Praktikat e trajtuara drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit



Hetim administrativ lidhur me ankesat e tatimpaguesve



Ankesa/Kërkesa të ardhura në rrugë elektronike



Ankesa/Kërkesa të ardhura në rrugë elektronike



■ Ankesa/Kërkesa drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit

■ Ankesa të ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes

2. Baza e të dhënave

Është bërë përditësimi i bazës së të dhënave me praktikat e ardhura, sipas Manualit të miratuar.

3. Promovimi i rolit të Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, në kuadër të zbatimit të programit të punës për vitin 2022, ka kryer inspektime verifikuese pranë disa drejtorive rajonale tatimore në Republikën e Shqipërisë, për disa çështje të ngritura mbi zbatimin e saktë të legjislacionit tatimor në fuqi.

Në vijim të këtyre inspektimeve verifikuese, në bashkëpunim me nëpunësit e drejtorive rajonale tatimore përkatëse, me qëllim promovimin e rolit të Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit realizoi vizita në disa tatimpagues që operojnë në territorin që mbulohet nga këto drejtori rajonale tatimore, në të cilët u shpërndanë broshura informuese mbi rolin, misionin dhe mënyrat e kontaktimit të Avokatit të Tatimpaguesit.

4. Promovimi i të drejtave të tatimpaguesve

Në kuadër të qëllimit për promovimin e të drejtave të tatimpaguesve, gjatë vitit 2022, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, sipas fushës së saj të përgjegjësisë, ka kryer rolin e saj duke informuar dhe edukuar njëkohësisht tatimpaguesit në lidhje me të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore.

Këtë proces, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit e ka kryer:

- Në rrugë elektronike, me publikimin e të drejtave që tatimpaguesit kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore (bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar), në faqen zyrtare web të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në seksionin “Avokati i Tatimpaguesit”, në brendësi të rubrikës “Të drejtat e tatimpaguesve”; dhe
- Në formë komunikimi të drejpërdrejtë me disa tatimpagues që janë kontaktuar në territorin që mbulohet nga drejtoritë rajonale tatimore në të cilat janë kryer inspektime verifikuese.

Ndërkohë, në çdo përgjigje sqaruese që i jepet tatimpaguesve në lidhje me kërkesat/ankesat që ata dërgojnë, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit i informon dhe i edukon njëkohësisht tatimpaguesit lidhur me të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore, si dhe lidhur me dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi që aplikohen në rastet konkrete.

5. Asistencë për tatimpaguesit lidhur me të drejtën për informim nga administrata tatimore mbi zbatimin e procedurës së fiskalizimit

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit është përfshirë edhe në procesin e informimit dhe asistimit të tatimpaguesve lidhur me procesin e fiskalizimit, në bazë të Planit të Punës për Vitin 2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me anë të shkresës me Nr. 3128 Prot., datë 18.2.2022, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me kërkesën për të publikuar në faqen e saj zyrtare web një njoftim për ndërgjegjësimin e tatimpaguesve mbi të drejtat që ata kanë në lidhje me zbatimin e procesit të fiskalizimit të faturës, dhe mbi të drejtën që ata kanë për t'iu drejtuar Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, në rrugë shkresore apo elektronike, kur më parë i janë drejtuar administratës tatimore për informim dhe asistencë lidhur me zbatimin e procedurës së fiskalizimit të faturës, dhe nuk kanë marrë sqarimet e nevojshme prej saj.

Në vijim të publikimit të këtij njoftimi nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve në faqen e saj zyrtare web, në adresën e postës elektronike të Avokatit të Tatimpaguesit janë paraqitur 17 ankesa/kërkesa, të cilat i janë përcjellë për trajtim administratës tatimore, në cilësinë e organit kompetent për të dhënë sqarimet e nevojshme, pasi nuk i ishin përcjellë më parë asaj.

Kërkesat drejtuar administratës tatimore për të trajtuar ankesat/kërkesat e tatimpaguesve lidhur me këtë proces, bazohen në të drejtën për informim dhe asistencë që ata kanë, referuar nenit 30 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. Detyra shtesë të kryera

- Përfaqësime në takime të niveleve të ndryshme në interes të Drejtorisë së Përgjithshme;
- Shqyrtim dhe trajtim të praktikave që lidhen me zbatimin e politikave fiskale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfshirë dhe ato të deleguara për kompetencë për t'u trajtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që lidhen me marrëdhëniet e tyre të drejtpërdrejta me tatimpaguesit, si organe ligjzbatuese;
- Çështje të tjera në interes të Drejtorisë së Përgjithshme, apo të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

7. Rekomandimet e dhëna nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit në raportet e mëparshme të vitit 2022

Nga Raporti për realizimin e programit të punës për 3-mujorin e parë të vitit 2022

Nga trajtimi i praktikave të ankesave/kërkesave të ardhura në adresë të Avokatit të Tatimpaguesit gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2022, bazuar në informacionet që kemi marrë, si dhe nga shqyrtimi i legjislacionit tatimor, kemi nxjerrë konkluzionet tona në lidhje me disa problematika që duheshin adresuar dhe për të cilat kemi dhënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Përgjigjet nga administrata tatimore lidhur me ankesat/kërkesat e tatimpaguesve, në veçanti në lidhje me procesin e fiskalizimit, nuk jepen brenda një afati të arsyeshëm për trajtimin e tyre.

Rekomandim: Të nxirret nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve një akt i veçantë, apo shtesë në manualin e proceseve të saj të punës, që rregullon funksionimin e marrëdhënieve të brendshme ndërmjet strukturave përkatëse të administratës tatimore qendrore të cilat trajtojnë ankesat/kërkesat e paraqitura në rrugë elektronike, ku të përcaktohen nëpunësit përgjegjës, si dhe afatet procedurale për kthimin e përgjigjeve, e në veçanti për ato që lidhen me procesin prioritar të fiskalizimit.

2. Problematika më e shpeshtë që është konstatuar nga tatimpaguesit lidhur me procesin e fiskalizimit, e cila është paraqitur në rrugë elektronike pranë Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, është mosgjenerimi i deklaratave doganore në sistemin elektronik dhe pamundësia për të kryer fiskalizimin e tyre.

Rekomandim: Të analizohet me kujdes ky shqetësim, për të identifikuar faktorët që sjellin një problematikë të tillë, në mënyrë që të gjendet rruga e mundshme e zgjidhjes në një afat kohor sa më të shkurtër, për t'u mundësuar tatimpaguesve importues të kryejnë plotësisht procedurën e fiskalizimit, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

3. Referuar nenit 44, paragrafi 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, transferimi në regjistrin pasiv nga administrata tatimore kryhet jo vetëm kur kërkohet nga tatimpaguesi pranë QKB-së, por edhe në rastet kur tatimpaguesi nuk ushtron më veprimtari tregtare apo nuk dorëzon deklaratat tatimore për 12 muaj të njëpasnjëshëm. Por, transferimi i tatimpaguesit në regjistrin pasiv kur nuk ushtron aktivitet apo nuk dorëzon deklaratat nuk pasqyrohet në regjistrin e QKB-së, por vetëm në regjistrin e administratës tatimore.

Pikërisht kjo është arsyeja që me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ligjvënësi ka ndryshuar nenin 44 të ligjit bazë, duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që të publikojë në faqen zyrtare të saj regjistrin e tatimpaguesve pasivë dhe duke i dhënë një rëndësi të veçantë publikimit të kësaj liste.

Kjo listë është një ndër dokumentet kryesorë ku tatimpaguesi informohet në lidhje me statusin e tatimpaguesit tjetër me të cilin kryen një transaksion, pasi dënimi lidhet ngushtësisht me publikimin e transferimit të tatimpaguesit në regjistrin pasiv nga administrata tatimore, dhe jo vetëm me faktin e kalimit të tij në regjistrin pasiv.

Rekomandim: Me qëllim vërtetimin në çdo moment të mëvonshëm se në çastin e kryerjes së transaksionit tatimpaguesi ka patur dijeni se tatimpaguesi tjetër me të cilin ka kryer transaksionin ka qënë i transferuar në regjistrin pasiv, çdo listë e publikuar më parë duhet të vijojë të qëndrojë e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Çdo

përditësim nuk duhet të ndryshojë listën e mëparshme, por duhet të publikohet si një listë e re (që mund të përfshijë ose jo të dhënat e listës së mëparshme).

4. Në “Raportin për realizimin e programit të punës për vitin 2020”, të përgatitur nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit dhe të dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet shkresës sonë me Nr. 19708 Prot., datë 1.2.2021, protokolluar në DPT me Nr. 1974 Prot., datë 2.2.2021, kemi dhënë rekomandimin për ofrimin e shërbimit online edhe për ankimin administrativ tatimor. Në kuadër të parimit të nxitjes së veprimtarive elektronike, risjellim në vëmendjen tuaj këtë rekomandim.

Rekomandim: Me qëllim lehtësimin e procedurave të ankimit administrativ tatimor, të krijohet mundësia e dërgimit të ankimit administrativ tatimor (kërkesës për apelim tatimor) në rrugë elektronike, në adresë të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke qenë se dhe vetë ligji procedural tatimor, nuk parashikon asnjë pengesë aplikimi të kësaj forme komunikimi.

Gjithashtu, të krijohet mundësia që akti administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore” i nxjerrë nga organi tatimor, që është objekt i një ankimi administrativ tatimor, të jetë direkt i aksesueshëm nga struktura e apelit tatimor në formë elektronike (me apo pa nënshkrim elektronik), dhe të mos jetë detyrim i tatimpaguesit për ta paraqitur këtë akt.

Synimi është përfshirja e shërbimit online edhe për të drejtën e ankimit administrativ tatimor, duke dërguar elektronikisht të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues në rrugë elektronike pranë strukturës së apelit tatimor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në vijim të këtyre rekomandimeve të dhëna nga drejtoria jonë, të përgjigjes së kthyer nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet shkresës me Nr. 7183/3 Prot., datë 10.6.2022, protokolluar me tonën me Nr. 7468/2 Prot., datë 21.6.2022, si dhe të komunikimit me tatimpagues të ndryshëm, kemi konstatuar se:

- Rekomandimi nr. 1 është vlerësuar dhe është marrë në konsideratë, por nuk kemi marrë informacion për nxjerrjen e një akti në përputhje me sa kemi rekomanduar;
- Rekomandimet nr. 2 dhe 3 janë marrë në konsideratë dhe iu është dhënë zgjidhje për periudhat në vijim;
- Për rekomandimin nr. 4 është shprehur dakordësia në parim mbi sa është propozuar nga ana jonë.

Nga Raporti për realizimin e programit të punës për 6-mujorin e parë të vitit 2022

Në vijim të sa është trajtuar në raportet e mëparshme të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, të informacioneve të marra gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2022 nga trajtimi i ankesave/kërkesave të tatimpaguesve, të ardhura në rrugë shkresore dhe elektronike, kemi dhënë rekomandimet e mëposhtme lidhur me problematikat që duheshin adresuar:

1. Lidhur me mosgjenerimin e deklarave doganore në Platformën Qendrore të Faturave të Administratës Tatimore.

Një nga problematikat më kryesore që është konstatuar nga tatimpaguesit lidhur me procesin e fiskalizimit, e cila është paraqitur në rrugë elektronike pranë Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, dhe për të cilën kemi dhënë rekomandimin përkatës në “Raportin mbi realizimin e programit të punës për 3-mujorin e parë të vitit 2022” të drejtorisë sonë, është mosgjenerimi i deklarave doganore në Platformën Qendrore të Faturave të Administratës Tatimore dhe pamundësia për t’u ngarkuar në deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar automatikisht. Rekomandimi i Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit ishte:

“Të analizohet me kujdes ky shqetësim, për të identifikuar faktorët që sjellin një problematikë të tillë, në mënyrë që të gjendet rruga e mundshme e zgjidhjes në një afat kohor sa më të shkurtër, për t’u mundësuar tatimpaguesve importues të kryejnë plotësisht procedurën e fiskalizimit, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.”

Në lidhje me rekomandimin e mësipërm të dhënë nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet shkresës me Nr. 7183/3 Prot., datë 10.6.2022, protokolluar me tonën me Nr. 7468/2 Prot., datë 21.6.2022, është shprehur se janë bërë përpjekje të vazhdueshme për trajtimin e kësaj problematike dhe dhënien e një zgjidhjeje optimale. Duke qenë se, problematika vijon ende të jetë e pazgjidhur, rekomandimi qëndron deri në zgjidhjen e saj.

2. Lidhur me gjenerimin e faturave për furnizimin me karburant të subjekteve, që i përdorin ato për efekt të llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme.

Një problematikë tjetër e konstatuar nga ankesat e disa tatimpaguesve, lidhet me pamundësinë e vendosjes së të dhënave identifikuese të një subjekti tatimor që furnizohet me karburant në një pikë furnizimi me pakicë të karburantit, duke sjellë si nevojë që, për efekt të llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme të këtij tatimpaguesi që furnizohet, të lëshohet përveç faturës që nxirret në mënyrë automatike nga pajisja fiskale e aparatit të distributorit, edhe një faturë tjetër elektronike nga kompjuteri (apo pajisje tjetër elektronike), nëpërmjet zgjidhjes software-ike në përdorim. Për rrjedhojë, në Platformën Qendrore të Faturave të Administratës Tatimore gjenerohen në kohë reale dy fatura elektronike për të njëjtën sasi karburanti të furnizuar të njëjtit subjekt tatimpagues.

Rekomandim:

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve të bashkëpunojë me subjektet që ofrojnë shërbimet softwerike për përmirësimin e programit në pajisjet fiskale të aparateve të distributorëve të karburantit, në mënyrë që në faturën e gjeneruar nga distributori në momentin e furnizimit të çdo subjekti, të bëhet e mundur dhe vendosja e të dhënave identifikuese të subjekteve tatimpaguese.

3. Lidhur me përjashtimin nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, hirrë qumështi dhe krem qumështi.

Në vijim të shtesës së kryer në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, nëpërmjet ligjit 112/2021, datë 25.11.2021, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, dhe më konkretisht me paragrafin 8, të shtuar në nenin 9, të këtij ligji, në të cilin është përcaktuar se:

“8. Përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi, fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë të evidentuar sasinë në përqindje të këtyre produkteve që janë trupëzuar në produktin përfundimtar. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit sipas kësaj pike përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor.”

Vlerësojmë se është e nevojshme që në rastin e përjashtimit nga pagesa e taksës për qumështin pluhur, hirrë qumështi dhe krem qumështi, të përfshihen të gjithë përpunuesit dhe prodhuesit, që këto produkte i trupëzojnë në produktet e tyre përfundimtare dhe që sasinë në përqindje të të cilave e evidentojnë në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Rekomandim:

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit rekomandon që, *Drejtoria e Harmonizimit Fiskal, si rast i përjashtimit nga pagesa e taksës për qumështin pluhur, hirrë qumështi dhe krem qumështi, të mos përfshijë vetëm fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, por edhe përpunues e prodhues produkteve të tjera, që në produktin përfundimtar të tyre kanë të trupëzuar qumështin pluhur, hirrën e qumështit apo krem qumështin, duke bërë rregullimet e nevojshme në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Në këtë mënyrë, garantohej jo vetëm parimi kushtetues i trajtimit të barabartë por shmanget dhe konkurrenca e pandershme në importimin/furnizimin me këto produkte që mund t’ju bëhet përpunuesve apo prodhuesve që nuk janë fabrika të prodhimit dhe përpunimit të qumështit.*

Në vijim të këtyre rekomandimeve të dhëna nga drejtoria jonë, kërkohet përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në veçanti lidhur me rekomandimin nr. 2, pasi për rekomandimin nr. 1 kemi konstatuar se i është dhënë zgjidhje për periudhat në vijim.

Lidhur me rekomandimin nr. 3 që është dhënë për Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konstatojmë se mbi çështjen që kemi parashtruar janë duke u zhvilluar diskutime në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, për t’i dhënë një zgjidhje ligjore asaj kategorie tatimpaguesish.

8. Mbi inspektimet e kryera pranë Drejtorive Rajonale Tatimore gjatë vitit 2022 dhe rekomandimet përkatëse për Administratën Tatimore

Drejtorja e Avokatit të Tatimpaguesit, në kuadër të zbatimit të programit të punës për vitin 2022, hartoi një plan për kryerjen e inspektimeve nëpërmjet anketimit pranë disa Drejtorive Rajonale Tatimore. Qëllimi i inspektimeve lidhej me funksionet dhe detyrat e Avokatit të Tatimpaguesit, në zbatim të nenit 105/2 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 28.7.2010, “Për Avokatin e Tatimpaguesit”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 25.2.2019, “Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga Avokati i Tatimpaguesve”, të ndryshuar.

Kryerja e inspektimeve pranë Drejtorive Rajonale Tatimore kishte si synim verifikimin e disa çështjeve të ngritura mbi zbatimin e saktë të legjislacionit tatimor në fuqi, si pjesë e misionit, funksioneve dhe detyrave të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, në vijim edhe të problematikave të paraqitura përgjatë vitit nga tatimpagues të ndryshëm.

Gjatë inspektimeve në Drejtoritë Rajonale Tatimore (DRT-të), në përfundim të të gjithë procesit të anketimit, Drejtorja e Avokatit të Tatimpaguesit ka konstatuar disa problematika, të cilat po i shprehim më poshtë:

1. Lidhur me zbatimin e procedurës së fiskalizimit nga tatimpaguesit.

Konstatohet se jo të gjithë tatimpaguesit të cilët janë të regjistruar pranë Drejtorive Rajonale Tatimore, janë të pajisur me certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit dhe lëshojnë faturë të fiskalizuar. Një nga arsyt kryesore rezulton të jetë fakti se ekzistojnë shumë tatimpagues të cilët rezultojnë me status “Aktiv” në regjistrin tregtar, por që faktikisht nuk e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, dhe nuk kanë ndjekur procedurën e çregjistrimit apo pezullimit të aktivitetit ekonomik.

Rekomandim:

Drejtorja e Avokatit të Tatimpaguesit rekomandon që, nga Drejtoritë e Shërbimit të Tatimpaguesit pranë Drejtorive Rajonale Tatimore, të mundësohet kontaktimi i të gjithë kësaj kategorie tatimpaguesish për t’i informuar lidhur me të gjitha detyrimet ligjore që ata kanë nëse vijojnë të jenë me status “Aktiv”, si dhe nëse dëshirojnë që të çregjistrojnë apo të pezullojnë aktivitetin e tyre ekonomik, të informohen mbi të gjithë procedurën që ata duhet të ndjekin në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Lidhur me lëshimin e faturës së fiskalizuar nga shoqëritë që operojnë në shërbimin e transportit publik.

Konstatohet se një segment i ndjeshëm i ekonomisë, siç është shërbimi i transportit publik të udhëtarëve, që ofrohet nga persona fizikë dhe juridikë, është aktualisht në pamundësi për të pajisur me faturë marrësit e shërbimit, duke qenë se në zbatim të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, shtypja e biletave në format letër me çmim të parashtypur, të transportit të udhëtarëve në shërbimin rrethqytetas, ndërqytetas dhe në transportin ndërkombëtar rrugor është ndërprerë, dhe gjithashtu nuk është krijuar mundësia teknologjike për pajisjen e udhëtarëve me biletë (faturë të fiskalizuar).

Rekomandim:

Përdorimi/furnizimi i udhëtarëve me biletat për transport të tyre nga shoqëritë që ofrojnë këtë shërbim në linjën përkatëse është objekt i kontrollit nga administrata tatimore nëpërmjet strukturave përkatëse pranë saj, për qëllimin e furnizimit të shërbimit (pajisjen e udhëtarëve me faturë-biletë), si dhe verifikimin e qarkullimit të realizuar nga tatimpaguesit e fushës së transportit të udhëtarëve për efekt të detyrimeve tatimore që lindin nga furnizimi i këtij shërbimi.

Në Kreun II, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 8.2.2017, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 224, datë 13.4.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”” (“VKM”), përcaktohet se:

“2. Tërheqja e biletave për transportin rrugor të udhëtarëve, për transportin qytetas, rrethqytetas dhe transportin ndërkombëtar rrugor, realizohet nga shoqëritë e licencuara për këto lloje transporti apo nga përfaqësuesi i agjencisë së transportit. Tërheqja e biletave kryhet pranë drejtorive rajonale tatimore, kundrejt kostos së prodhimit të tyre.

Gjithashtu, tërheqja e biletave për transportin rrugor, qytetas dhe rrethqytetas të udhëtarëve mund të realizohet edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.”

Theksojmë se në pikën 1, të këtij Kreu, është përcaktuar dhe se si realizohet shtypja e biletave me format letër për këto lloje transporti udhëtarësh, lidhur dhe me zbatimin e pikës 2, të cituar më lart.

Njëkohësisht, për mundësimin e përdorimit të biletave elektronike, në zbatim edhe të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, siç edhe përcaktohet në kreun III të VKM-së së sipërpërmendur, në pikën 6 të këtij Kreu, përcaktohet se:

“6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për transportin, të paktën 3 muaj përpara fillimit të aplikimit të biletës elektronike, duhet të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në mënyrë që të planifikojë dhe të rakordojë kërkesat për biletat me çmim të parashtypur.”

Në lidhje me zbatimin e kësaj pike, duhet të merret në konsideratë parashikimi i pikës 2 dhe 4 të këtij Kreu, ku përcaktohet se:

“2. Autoriteti kombëtar i licensimit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore administrojnë vetë ose me të tretë, të cilët janë subjekte të licensuara/të autorizuar/të kontrajtuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, biletat elektronike dhe sistemin e biletimit elektronik, përkatësisht në linjat e transportit ndërqytetas/ndërkombëtar të udhëtarëve dhe në linjat e transportit qytetas/rrethqytetas të udhëtarëve.”

“4. Procedurat për zgjedhjen e subjekteve të përmendura në pikën 2, të këtij kreu, subjekte publike ose private, kryhen nga ministria përgjegjëse për transportin ose njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.”

Pra, nga sa shprehet në këto pika, tatimpaguesit që ofrojnë shërbimin e transportit publik të udhëtarëve nuk mund të zgjedhin vetë subjektin që ofron zgjidhjen software-ike për biletimin elektronik, pa u përzgjedhur ato më parë nga strukturat përkatëse të ngarkuara nga VKM. Në rast konstatimi nga strukturat e verifikimit në terren të administratës tatimore, një situatë e tillë mund të sjellë si pasojë penalizimin pa të drejtë të tatimpaguesve që operojnë në ofrimin e këtij shërbimi, për moslëshimin e faturës (biletës) së fiskalizuar për përfituesit e këtij shërbimi, ndërkohë që nuk është përgjegjësia e tyre në këtë rast.

Theksojmë se VKM nr. 224, datë 13.4.2022, që ka ndryshuar VKM-në nr. 85, datë 8.2.2017, i shtrin efektet nga data 1 janar 2023. Duke qenë se, ligji nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, ka hyrë në fuqi përpara hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je, në kushtet kur DPT është përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e lëshimit të faturës së fiskalizuar, si dhe duke marrë në konsideratë që në zbatim të ligjit për fiskalizimin (ligji nr. 87/2019) shtypja e biletave në format letër me çmim të parashtypur, të transportit të udhëtarëve në shërbimin rrethqytetas, ndërqytetas dhe në transportin ndërkombëtar rrugor **është ndërprerë dhe subjektet që operojnë në këto linja nuk furnizohen me bileta të transportit të udhëtarëve, DPT të bashkëpunojë dhe të paraqesë propozime konkrete, nëse është e nevojshme edhe për ndryshim ligjor në dispozitat tranzitore të legjislacionit që rregullon procedurën e fiskalizimit, për zgjidhjen e situatës së krijuar në treg për furnizimin me këto bileta.**

Një zgjidhje sa më e shpejtë për këtë çështje do të shmangte dhe mundësinë e penalizimit të kësaj kategorie të tatimpaguesve, për shkak të moslëshimit të faturës së fiskalizuar për shërbimin që ofrojnë, në rast kontrolli nga strukturat përkatëse të administratës tatimore.

3. Lidhur me kufirin minimal të regjistrimit për përgjegjësinë tatimore për tatimin mbi fitimin dhe/ose për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Konstatohen raste kur subjektet që kanë kaluar në statusin “Pezulluar” përpara miratimit të ndryshimeve në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe në ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me kufirin minimal të regjistrimit për përgjegjësinë tatimore, në momentin kur kalojnë në status “Aktiv” pas miratimit të këtyre ndryshimeve ligjore, vijnë të trajtohen si subjekte me përgjegjësi tatimore për tatimin mbi fitimin dhe/ose për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht se qarkullimi i tyre nuk e justifikon këtë fakt.

Rekomandim:

Të trajtohen me kujdes të gjitha kërkesat e tatimpaguesve të cilët kanë kaluar në statusin “Pezulluar” përpara miratimit të ndryshimeve në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe në ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me kufirin minimal të regjistrimit për përgjegjësinë tatimore, dhe që kalojnë në status “Aktiv” pas miratimit të këtyre ndryshimeve ligjore, për të mundësuar që trajtimi i tyre si subjekte me përgjegjësi tatimore për tatimin mbi fitimin dhe/ose për tatimin mbi vlerën e shtuar të jetë në përputhje me ndryshimet ligjore, dhe të mos i shfaqen pengesa apo vonesa në kohë këtyre tatimpaguesve lidhur me këtë çështje.

4. Lidhur me shqetësimin e ngritur nga tatimpagues të ndryshëm të kontaktuar.

Në objektin e vizitave të planifikuara pranë DRT-ve, Avokati i Tatimpaguesit përfshiu si pjesë të programit të punës edhe kontakte të drejtpërdrejta me tatimpagues të ndryshëm, të cilët zhvillonin veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e DRT-ve përkatëse. Këto takime u organizuan në bashkëpunim me strukturat përkatëse të DRT-ve.

Takimet kishin si qëllim kryesor promovimin tek tatimpaguesit të rolit dhe përgjegjësisë që ka Avokati i Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit dhe edukimin ligjor të tatimpaguesve mbi të drejtat që ata kanë në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore. Njëkohësisht, në takimet e zhvilluara pati shkëmbime mendimesh dhe nxjerrje të problematikave të ndryshme që shqetësojnë tatimpaguesit.

Një nga shqetësimet kryesore të tatimpaguesve që Avokati i Tatimpaguesit konsideron se duhet të marrë zgjidhje konkrete është:

- Një numër i konsiderueshëm tatimpaguesish janë gjendur në pamundësi për të lëshuar fatura, për shkak të mosinformimit paraprak lidhur me përfundimin e afatit 1-vjeçar të vlefshmërisë së Certifikatës Elektronike në kuadër të projektit të fiskalizimit, dhe duke marrë parasysh që aplikimi për këtë certifikatë dhe nxjerrja e saj nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) kërkon një kohë të konsiderueshme, ata gjenden në një situatë ku nuk mund t'i ofrojnë marrësit të mallrave apo shërbimeve një faturë të fiskalizuar, duke i ekspozuar

kështu edhe ndaj penalteteve që mund të vendosen nga organet tatimore në rast të një kontrolli tatimor.

Rekomandim:

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit rekomandon që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të komunikojë me të gjithë ofruesit e zgjidhjeve software-ike për mundësimin që të paktën një muaj para përfundimit të afatit 1-vjeçar të vlefshmërisë së Certifikatës Elektronike në kuadër të projektit të fiskalizimit, në faturat që tatimpaguesit lëshojnë, të shfaqet një njoftim lidhur me datën e fundit të vlefshmërisë së saj, në mënyrë që tatimpaguesit të marrin masa paraprake për rinovimin e saj në kohë. Një mënyrë tjetër mund të jetë edhe shfaqja e këtij njoftimi në formë “pop-up” përgjatë përdorimit të zgjidhjes software-ike apo në Platformën Self-Care (për tatimpaguesit që kanë mundësinë ta përdorin atë pa pagesë për lëshimin e faturave) në çdo ditë të muajit të fundit të vlefshmërisë së Certifikatës Elektronike në kuadër të projektit të fiskalizimit.

III. Rekomandime të tjera për Administratën Tatimore

1. Në vijim të rekomandimit nr. 4 të dhënë nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit në “Raportin mbi realizimin e programit të punës për 3-mujorin e parë të vitit 2022” dhe të dakordësisë në parim të Drejtorisë së Përgjithshme të shprehur nëpërmjet shkresës me Nr. 7183/3 Prot., datë 10.6.2022, protokolluar me tonën me Nr. 7468/2 Prot., datë 21.6.2022, mbi sa është propozuar nga ana jonë lidhur me mundësimin e shërbimit online edhe për të drejtën e ankimit administrativ tatimor pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, akti administrativ kryesor i cili duhet t’i vihet në dispozicion tatimpaguesit nga organi tatimor është “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore”, që është objekt i një ankimi administrativ tatimor.

Rekomandim: Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit rekomandon që, duke u nisur nga fakti se Administrata Tatimore ka zhvilluar ofrimin e shërbimeve online, si hap i parë për realizimin e procesit të ankimit administrativ tatimor në rrugë elektronike, të shihet mundësia e gjenerimit elektronik nga sistemi informatik tatimor “e-filing” të aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrime Tatimore” me nënshkrim elektronik, me datë të informatizuar në momentin e gjenerimit, për t’u paraqitur së bashku me ankesën brenda afatit ligjor pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, si akt i vlefshëm për efekt të shqyrtimit të ankesës.

2. Nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit janë konstatuar disa raste ku tatimpaguesit, të cilët kanë aplikuar për çregjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), pengohen nga organi tatimor, të cilit i komunikohet nga QKB kërkesa për çregjistrim e tatimpaguesit, dhe kjo pengesë bëhet për shkak të gjendjes me tepriçë kreditore të tij, edhe pse në vlera të vogla.

Rekomandim: Për raste të tilla, rekomandojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të orientojë me udhëzues unifikues drejtoritë rajonale tatimore për ndjekjen me prioritet të

procedurave të parashikuara në legjislacionin tatimor për kthimin e tepricës kreditore në favor të subjekteve tatimpaguesve, duke shmangur zvarritjet jo vetëm për tatimpaguesit në këtë status, por edhe për administratën tatimore. Zgjidhja e kësaj situatë ndihmon në paraqitjen e gjendjes reale të subjekteve tatimpaguese që nuk ushtrojnë aktivitet por për shkak të kësaj situatë figurojnë aktivë në sistemin tatimor.

3. Nga tatimpaguesit të cilët operojnë në fushën e këmbimit valutor, konkretisht nga zyrat e këmbimit valutor, janë paraqitur ankesa të vazhdueshme mbi procesin e fiskalizimit të aktivitetit të këmbimit valutor, në veçanti lidhur me mënyrën e llogaritjes së qarkullimit vjetor mbi të cilin përcaktohet dhe kufiri për kalimin në përgjegjësinë tatimore për tatimin mbi fitimin dhe/ose për tatimin mbi vlerën e shtuar. Këta tatimpagues theksojnë se e ardhura në këtë sektor është vetëm diferenca që del ndërmjet shumave të arkëtuara dhe paguara për çdo valutë (blerje/shitje) dhe jo çdo veprim i regjistruar dhe shume të konvertuar në monedhën LEK.

Rekomandim: Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit rekomandon që lidhur me këtë problematikë, të gjendet një zgjidhje në sistemin e fiskalizimit duke evidentuar të ardhurat/qarkullimin real nga ushtrimi i veprimtarisë së kësaj kategorie. Në rast se kësaj kategorie tatimpaguesish i ndryshohet përgjegjësia tatimore, si rrjedhojë e kalimit të kufirit minimal për regjistrimin në përgjegjësinë tatimore për tatimin mbi fitimin dhe/ose për tatimin mbi vlerën e shtuar sipas mënyrës aktuale të llogaritjes, kjo sjell kosto shtesë për ta, duke i çuar shpesh edhe në vështirësi financiare për vijimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik.

Ju faleminderit!

Janar 2023

AVOKATI I TATIMPAGUESIT